

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	PRISHTINA 
---	--	--

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22 dhe 44, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 nr.350/02-70487/20 dt.14.05.2020, të pronarëve Flutura dhe Arian Haxhijaha, nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për ndërtimin e shtëpisë së banimit me afarizëm, në bllokun "G-14" të tërësisë urbane "G", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës në procedurë administrative, me datë 18.06.2020, merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I Caktohen kushtet ndërtimore pronarëve Flutura dhe Arian Haxhijaha, nga Prishtina, sipas kërkesës 05 nr.350/02-70487/20 dt.14.04.2020, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin shtëpisë së banimit me afarizëm, me etazhitet P+2, në kuadër të parcelës ndërtimore "G-14-14" të bllokut urban "G-14" të tërësisë urbane "G", të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim" në Prishtinë, përkatësisht në parcelën kadastrale nr. 738-0, ZK Çagllavicë.

II. Lokacioni, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore gjendet në kuadër të Planit Rregullues "Prishtina e Re-Zona Perëndim", i miratuar me Vendimin e Komunës së Prishtinës 01 nr. 35-186850 dt. 02.10.2013, dhe sipas këtij plani kjo zonë është e paraparë për ndërtim individual. Lidhur me këtë dhe me parametrat e ndërtimit nga ky plan, pronarët janë informuar përmes shkresës "Informim nga Plani Rregullues Prishtina e Re - Zona Perëndim" me referencë 04 Nr.350/01-54384/20 dt.09.03.2020, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Komuna e Prishtinës.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 - nr. 738-0, me $S = 1253 \text{ m}^2$, me pronar Flutura dhe Arian Haxhijaha, "Arë e klasës së 5-të;
 - E trajtuar me këtë Vendim për caktimin e kushteve ndërtimore, është vetëm sipërfaqja pre $S = 870 \text{ m}^2$, e cila shtrihet brenda vijës rregulluese të Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim".
 - Sipërfaqja që del jashtë vijës rregulluese, përkatësisht e planifikuar për infrastrukturë rrugore sipas këtij Plani, është $S = 195 \text{ m}^2$.

- Sipërfaqja që mbetet e patrajtuar sipas këtij Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, përkatësisht pjesa që shtrihet në parcelat ndërtimore "G-14-13" dhe "G-14-20", është $S=188m^2$.
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjeve së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Bazuar në certifikatat e njësisë kadastrale, parcela kadastrale nr. 738-0 është tokë bujqësore me kulturë 'Arë e klasës së 5-të'.
- Parcela kadastrale në fjalë, është e zbrazët, dhe nuk ka ndërtesa të ndërtuara në to;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni është i relativisht i rrafshët;
- Qasja në parcelë kadastrale është përmes rrugës ekzistuese, që kalon tutje në rrugën e planifikuar;
- Parcela kadastrale e lartcekur shtrihet në bllokun urban "G-14", përkatësisht pjesa e trajtuar me sipërfaqe prej $S=870 m^2$, shtrihet vetëm brenda parcelave ndërtimore "G-14-14" dhe "G-14-15", kufiri i të cilave është ndryshuar sipas këtij Vendimi;
- Në diametër prej 50 m' ka ndërtesa të ndërtuara dhe destinimi i tyre është banim individual.

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin – ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit, bazuar në parametrat urban të planit, janë:

- Organizimi me qasje në kuadër të parcelës kadastrale, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës, në raport me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, distanca e ndërtesës nga kufiri i parcelave, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik si dhe në bazë të "Situacionit të parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese në sistemin koordinativ KOSOVAREF01", bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Destinimi i shfrytëzimit të objektit të jetë për banim individual me afarizëm në përdhësë;
- Etazhiteti maksimal i objektit sipas planit dhe i propozuar është P+2;
- Indeksi i shfrytëzimit të parcelës (ISHP) duhet të jetë 30% e sipërfaqes së parcelës ndërtimore;
- Indeksi i sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore (ISPN) të jetë max. 450 m²;
- Indeksi i shfrytëzimit të nëntokës (ISHN) duhet të jetë 60%;
- Indeksi i sipërfaqes së gjelbërimit (ISGJ) duhet të jetë 40%, sipas Vendimit të kryetarit 01-031-185481 dt.14.08.2015;
- Qasja në objekt duhet të jetë nga rruga lokale ekzistuese, dhe rruga e planifikuar sipas Planit Rregullues;
- Distanca më e vogël nga parcela fqinje është 3.0 m`. Në rastin që kjo distancë tejkalohet, duhet patjetër të sigurohet pëlqimi i noterizuar i fqiut, mirëpo në këtë rast nuk lejohen hapjet e kthinave primare;
- Terasat, shkallët e jashtme, ballkonet, konzollat, etj., nuk mund të ndërtohen në distancë më të vogël se 3.0 m` nga parcela fqinje, apo jashtë vijës ndërtimore;
- Kuota e nivelit të përdhësës 0.45 m mbi nivelin e trotuarit;
- Në një parcelë ndërtimore, përveç ndërtesës kryesore, mund të ndërtohen edhe objektet ndihmëse që formojnë tërësi banimi apo tërësi ekonomike (si p.sh. garazhat, etj.);
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2015 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të

energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;

- Në kuadër të objektit ose parcelës ndërtimore të parashihet nga një vendparking për çdo njësi banimi, ndërsa për afarizëm, 1 vendparking për 25 m², si dhe për depo 1 vendparking për 100 m²;
- Rrethojat kryesisht duhet të jenë transparente apo rrethoja të gjelbra. Baza e rrethojës nuk duhet të jetë më e lartë se 50cm, mund të jetë nga betoni, tulla apo guri. Pjesa e rrethojës mbi bazë duhet të ndërtohet me materiale të lehta sikur druri, metali apo diçka e ngjashme. Rrethoja përkaj rrugës ka lartësi prej max 1.5 m, ndërsa në kufi me parcelën fqinje mund të jetë max 2.0 m;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura e objektit të ri ti përshtatet ambientit që e rrethon, vlerave ambientale, duke pasur kujdes në harmonizimin e vertikalitetit dhe horizontalitetit të volumit të ndërtesës dhe me karakteristika të kulturës urbane;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që uji i strehëve duhet të pikojë brenda parcelës kadastrale;

V. Pëlqimi për ndërrimin e planit të riparcelimit - duke qenë se Parcela kadastrale nr.738-0 ZK Çagllavicë, përkatësisht pjesa që po trajtohet me këtë Vendim, shtrihet në të njëjtat parcela ndërtimore me parcelën kadastrale nr. 737-0 ZK Çagllavicë, përkatësisht në parcelat ndërtimore "G-14-14" dhe "G-14-15", kjo Drejtori, bazuar në Pëlqimin e noterizuar LRP.nr.1361/2020 dt.16.06.2020, e miraton ndryshimin e kufirit të riparcelimit për parcelat ndërtimore "G-14-14" dhe "G-14-15", ky kufi tani është në kufi të parcelave kadastrale nr.738-0 dhe 737-0 ZK Çagllavicë.

Ky ndryshim ka të bëjë vetëm me parcelat ndërtimore "G-14-14" dhe "G-14-15", dhe si i tillë nuk i prek parcelat tjera ndërtimore në kuadër të bllokut në fjalë.

Në rast të zhvillimit të parcelave ndërtimore "G-14-13" dhe "G-14-20", pronari i parcelës kadastrale nr.738-0 ZK Çagllavicë, duhet të jetë i gatshëm të kontribuoj me pëlqimet përkatëse.

VI. Ndarja e parcelës kadastrale nr.738-0 ZK Çagllavicë, do të realizohet sipas dispozitës urbanistike me koordinatat e vijës rregulluese, ndërtimore si dhe vijave të riparcelimit të parapara sipas Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", të punuar nga kjo drejtori, si dhe bazuar në Planin e situacionit - "zgjidhjes urbane".

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelës kadastrale të lartcekur, sipas Planit të situacionit - "zgjidhjes urbane", dhe dispozitës urbanistike. Procedura e ndarjes do të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas këtyre kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve, duke u bazuar në Planin e situacionit-"zgjidhjen urbane" dhe dispozitën urbanistike, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VII. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Vendimin për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;

- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçe nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VIII. Dokumentacioni ndërtimor - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m², me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhesë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhesë dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tridimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme

IX. PAGESA E KOMPENSIMIT PËR NDËRRIMIN E DESTINIMIT TË TOKËS BUJQËSORE - meqenëse parcela kadastrale nr. 738-0, Zona Kadastrale Çagllavicë, në bazë të çertifikatës së njësisë kadastrale, është evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës - tokë bujqësore, me kulturë 'arë e klasës 5', kërkohet që paraprakisht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11, 13 dhe 14 të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8, 9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit - "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej S=870 m² (sipërfaqja në trajtim sipas këtij Vendimi, që shtrihet brenda vijës rrgulluese). Kjo sipërfaqe do të

regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore,

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

X. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të “Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të aplikuesit.

XI. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas “Rregullores mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01Nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XII. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Pronarët, Flutura dhe Arian Haxhijaha, nga Prishtina, me kërkesën 05 nr.350/02-70487/20 dt.14.05.2020, kanë kërkuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e shtëpisë së banimit me afarizëm, me etazhitet P+2, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të këtij Vendimi.

Me kërkesë, pronarët kanë prezantuar dokumentacionin, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë e parcelës kadastrale nr. 738-0 ZK Çagllavicë, e evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale, P-71914075-00738-0.
- Informimin nga Plani Rregullues “Prishtina e Re – Zona Perëndim” me referencë 04 Nr.350/01-54384/20 dt.09.03.2020

- Incizimin gjeodezik, të punuar nga kompania e licensuar gjeodete "GeoHorizont" sh.p.k., me numër të licencës 54;
- Projektin konceptual për parcelën kadastrale në fjalë, të hartuar nga "Locus" sh.p.k. me numër të certifikatës së biznesit 811290204, me seli në Prishtinë;
- Deklaratën / Pëlqimin për paluajtshmërinë, LRP.nr.858/2020 dt.05.03.2020, sipas të cilit z.Ardian Sadiku, në cilësinë e pronarit të parcelës kadastrale nr.739-2 ZK Çagllavicë, pajtohet dhe jep pëlqimin që fqinjët e tij z. Arian dhe znj. Flutura Haxhijaha, me ndërtimin në kuadër të parcelës kadastrale nr.738-0 ZK Çagllavicë, ti afrohen parcelës së dhënësit të këtij pëlqimi për 1m';
- Deklaratën / Pëlqimin për paluajtshmërinë, LRP.nr.741/2020 dt.24.02.2020, sipas të cilit z.Ardian Klllokoqi, në cilësinë e pronarit të parcelës kadastrale nr.741-0 ZK Çagllavicë, pajtohet dhe jep pëlqimin që fqinjët e tij z. Arian dhe znj. Flutura Haxhijaha, me ndërtimin në kuadër të parcelës kadastrale nr.738-0 ZK Çagllavicë, ti afrohen parcelës së dhënësit të këtij pëlqimi për 1m';
- Deklaratën / Pëlqimin për paluajtshmërinë, LRP.nr.1361/2020 dt.16.06.2020, sipas të cilës, z.Gani Sopi në cilësinë e pronarit të parcelës kadastrale nr.737-0 ZK Çagllavicë, pajtohet dhe jep pëlqimin që fqinjët e tij z.Arian dhe znj.Flutura Haxhijaha, shtëpinë e tyre ta ndërtojnë në pronën e tyre, përkatësisht parcelën kadastrale nr.738-0 ZK Çagllavicë, pa e përfshirë parcelën e dhënësit të pëlqimit, dhe pajtohen që të afrohen deri në 1m' nga kufiri i parcelës së tij;
- Vërtetimet mbi obligimet tatimore të aplikuesve;
- Fotokopjet e dokumenteve të identifikimit, si dhe;
- Fotot e lokacionit.

Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës në fjalë, si dhe dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni, Planit Rregullues "Prishtina e Re - Zona Perëndim", si dhe bazuar në rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektin konceptual, bazuar në nenin 13, pika 1.2 të UA të MMPH-së Nr. 06/2017 dt.23.05.2017, ka vendosur njoftimin me datë 22.05.2020. Ky njoftim publik, sipas rregullativës ligjore, ka qëndruar pesë 5 ditë në lokacionin në fjalë dhe meqë ndërkohë kjo drejtori nuk ka pranuar ndonjë vërejtje apo sygjerim, është vazhduar me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.

Pas procedurës së njoftimit publik, bazuar në konstatimet e më sipërme, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L- 110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 7 dhe 8 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se aplikuesit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, dhe se projekti konceptual i prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të Planit Rregullues Urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacionit -"zgjidhja urbane", dhe manuali gjeodezik për ndarjen e parcelës kadastrale.


Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPH-ja.

Ky Vendim u përpilua në katër (4) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesve, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

Kopja elektronike e këtij Vendimi ti dërgohet: Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Drejtorisë së Kadastrit.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 Nr. 350/02-70487/20 dt. 18.06.2020

Punoi,
Krenare Shkodra



U.D. Udhëheqëse e Sektorit,
Mimoza Berisha Prestreshi




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01




Punoi:
Kushtrim Domaneku

Legjenda:

- Vija Rregulluese sipas PRRU
- Vija Ndërtimore sipas PRRU
- Parcelat Kadastrale

Prishtinë: 04.06.2020



PROJEKTI:	SHTËPI INDIVIDUALE P+2		SEKSIONI I PROJEKTTIT:	
LOKACIONI:	Cagllavicë, PRISHTINË		PROJEKTI IDEOR	
INVESTITOR:	Arian Haxhijaha		TITULLI:	
PROJEKTUES:	ARKITEKTE:		Situacioni i ngushtë	
	Adelina Tahiri		FORMATI I LETRËS:	PËRPJESA:
	Valdete Pacolli		ISO - A3	1:300
		DATA:	PAGE:	
		Maj, 2020	04	